



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 358/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, kështu që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 1350 (njëmijetreqind ) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

PZAP-i, me datën 28.10.2013 ka pranuar ankesë nga LVV, në të cilën pretendohet se me datën 26.10.2013, te Santea në Prishtinë, anëtarë të subjektit politik AAK, kanë vendosur posterë të kandidatës nga ky subjekt Vesa Kada në rrugë publike. Parashtruesi i ankesës me këtë rast konsideron se është bërë shkelje e nenit 33 pika b e LZP-së, nenit 4.1 pika b e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013. Ankesës i ka bashkangjitur si provë fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik AAK, me datën 28.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 29.10.2013 deri në . PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik, sipas afatit të caktuar në të cilën deklaroi se vendosja e posterit të kandidatës së AAK-së, për asamble komunale në Prishtinë, Vesa Kada, mbi rrugë publike nuk është bërë nga ana e strukturave të AAK-së, por pretendon se vendosja e posterit mund të jetë bërë nga qytetar apo individ të pa identifikuar, dhe se me të pranuar njoftimin për ankesë ka kontaktuar me struktura menaxhuese për të bërë heqjen e këtyre posterave, ndërsa përgjigjes në ankesë subjekti i AAK-së, ka bashkangjitur provat si: udhëzimin e Kryetarit të AAK-së, drejtuar të gjitha strukturave për respektimin e ligjit për Zgjedhjet dhe rregulloret të KQZ-së, Fotografi në të cilat dëshmohet veprimi i largimit të posterit të vendosur mbi rrugë publike, kërkesën drejtuar shefave të shtabeve zgjedhore për respektim të kodit zgjedhor.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e bazuar**

Në fotografitë e bashkangjitura si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit i kandidatit të subjektit politik AAK, Vesa Kada, është i vendosur në rrugë publike,

gjë që është në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe neni 33 pika b) të LZP-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që ndalojnë vendosjen e pllakateve , posterave dhe njoftimeve në rrugë publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Meqenëse subjekti politik AAK, ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe lidhur me faktin se posterit i kandidatës së AAK-së, ka qenë i vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e posterave si dhe poashtu subjekti i njëjtë politik ka bërë shkeljes të njëjtës natyre edhe më parë në këto zgjedhje, PZAP e mori si rrethanë rënduese. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se subjekti politik AAK, pas marrjes së kërkesës për përgjigje në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes, duke i larguar menjëherë posterin nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i, duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstatoi se subjekti politik AAK-ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika “b” të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që posterit i kandidatës nga ky subjekt , është i vendosur në rrugë publike, i cili veprim është ndaluar me dispozitat e cituara më lart, ndërsa duke marrë parasysh se subjekti politik AAK, ka ndërmarr veprime të menjëhershme për evitimin e shkeljes së supozuar, si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara siç shihet nga fotot si provë të bashkangjitura përgjigjës në ankesë, veprim i cili ka ndikuar në lartësinë e gjobës, andaj në kuptim të, nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë**

Anr. 358/2013 më datën 31.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*